



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Njoftim për media

AZHBR: Programi IPARD auditohet nga BE

AZHBR duke qenë gjithnjë e interesuar të ndajë me publikun të vërtetat e punës së saj, në mënyrë transparente sjell në vëmendje se informacioni mbi të gjithë financimet e disbursuara nga Programi IPARD II është i aksesueshëm nga të gjithë qytetarët. Programi është akredituar nga strukturat e BE-së si dhe audituar dhe certifikuar nga Agjencia e Auditimit të fondeve IPA, Auditoret e Komisionit Europian dhe strukturat monitoruese për zbatimin e programit.

AZHBR ka ecur me hapa të shpejtë dhe të kënaqshme në përthithjen dhe disbursimin e fondeve sipas parashikimeve të Programit, fakt të cilin e tregon edhe aprovimi nga strukturat europiane të Programit IPARD III me një fond prej 146 milionë euro, duke e renditur Shqipërinë vendin e parë në rajon për thithjen e fondeve të BE-në në sektorin e bujqësisë.

Gjithashtu, AZHBR po punon për krijimin e një sistemi të aplikimeve online për Programin IPARD III, si një risi që ofron lehtësi për aplikantët, rrit transparencën dhe shmang barrierat administrative.

Të njëjtat arritje janë konfirmuar edhe në Raportin Progresin për Shqipërinë, publikuar nga Komisioni Europian për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022, për punën e bërë në një vit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, veçanërisht në rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve për miratimin e Programit IPARD III si dhe zbatimin e suksesshëm të Programit IPARD II”.

Për ta bërë edhe më të thjeshtë konstatimin e fakteve, përcjellim hapat nëpërmjet të cilëve kalojnë aplikimet.

PROCESI I VLERESIMIT TË APLIKIMEVE NË AZHBR:

Në momentin e shpalljes së thirrjes për aplikime, publikohet zyrtarisht udhëzuesi për aplikantët me kriteret e përfitueshmërisë për secilën nga masat e investimit.

Pjesë e udhëzuesit është lista e dokumenteve të cilat duhet të dorëzohen në mënyrë që të miratohet projekti për financim me grant.

VERIFIKIMI ADMINISTRATIV

Statusi ligjor dhe financiar i aplikantit:

Gjendja juridike e aplikantit/përfaqësuesit ligjor (i dënuar ose jo nen hetim ose jo), nëpërmjet vërtetimeve nga autoritetet kompetente.

Formalizmi i ekonomisë, nëpërmjet regjistrimit në QKB (aktiv dhe me aktivitet)

Legjitimiteti për kryerjen e shërbimeve në kuadër të investimeve (pajisja me license)

Shlyerja e detyrimeve tatimore, taksave kundrejt shtetit.

Qëndrueshmëria e investimit:

Verifikimi dhe vlerësimi i Planit të Biznesit ose Projekti Teknik (IRR dhe NPV)

Te drejtën e pronësisë/përdorimit në pronën ku kryhet investimi

Vlerësimi i investimit nëpërmjet verifikimit të projekteve (konstruktiv, arkitektonik, teknologjik etj) në varësi të investimit.

Plotësimi i standardeve, investimi plotëson standardet minimale kombëtare dhe ato të BE në varësi të masës dhe investimit (standardet e mjedisit, sigurisë ushqimore, sigurisë në punë etj.)

VERIFIKIMI NË TERREN

Verifikohen elementët e deklaruar në aplikim nëse i korrespondojnë apo jo faktit lidhur me;

- pronësinë,
- standardet minimale dhe ato të BE-së,
- gjendjen e investimit dhe
- përputhshmërinë me projektin e aplikuar.

MONITORIMI EX-POST

Kryhet brenda 5 viteve nga ekzekutimi i pagesës. AZHBR verifikon n.q.s. përfituesi vijon të mbajë në funksion investimin sipas kushteve të kontratës.